



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63.4 dhe neni 29.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 03.09.2021 merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për decertifikimin e kandidatëve të Partisë Demokratike të Kosovës, **Sokol Bashota** dhe **Enver Berisha**.
- II. Këta kandidat decertifikohen për të marrë pjesë në zgjedhjet për Kryetar Komune dhe Kuvend Komunal në Komunën e Klinës.
- III. Zyra obligohet që të njoftoj kandidatët **Sokol Bashota** dhe **Enver Berisha** për marrjen e këtij Vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Aktgjykim i Gjykatës së Apelit me nr. PA1. Nr. 400/2021 i cili vërteton aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr. 168/2016 të datës 19.02.2021 që ka të bëjë me kandidatin për Kryetar Komune për komunën e Klinës nga PDK **Sokol Bashota**, dhe kandidatin për antarë në Kuvendin Komunal të Klinës, **Enver Berisha**, gjithashtu nga PDK, ka vërtetuar që z. **Bashota** dhe z. **Berisha** kanë humbur aftësinë për të qenë kandidat sepse kandidaturat e tyre nuk janë në përputhje me nenin 29, paragrafi 1, pika q) e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Kandidati për Kryetar Komune për Komunën e Klinës **Sokol Bashota** dhe kandidati për antarë të Kuvendit Komunal të komunës së Klinës **Enver Berisha** nga Partia Demokratike e Kosovës, sipas nenit 29.4 të nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, kanë arritur statusin sipas të cilit ata kanë humbur aftësinë për të qenë kandidat.

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radonjigj



Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.